

NDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
LËKKA JE PRAVNO SNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Udhë

28-08-2018



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Zyrtaren ligjore Liridona Mehmeti-praktikante e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy nga Fshati [REDACTED] Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.2135-7/2017 të dt.14.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 11.07.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të pandehurve, mbrojtësit të të akuzuarit [REDACTED] Av. [REDACTED] në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Lipjan i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, punon si punëtor fizik, i martuar, baba i katër fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor ndërtimtarie në lyerje dhe izolim, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-
2. [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Lipjan i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor ndërtimtarie në lyerje dhe izolim, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

JANË FAJTORË

Sepse me datën 21.09.2017, rreth orës 00:00, në Rrugën "Dëshmorët e Kombit" në Ferizaj, të pandehurit së bashku me të miturin [REDAKTUAR], lehtë e lëndojnë të dëmtuarin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në mes tyre, i sulmojnë fizikisht të njëjtit, ku fillimisht i mituri [REDAKTUAR] me një mjet të fortë-qekan, e godet të dëmtuarin [REDAKTUAR] në shpinë dhe të dëmtuarin [REDAKTUAR] në hundë e pastaj së bashku me të pandehurin [REDAKTUAR] e godasin me grushta [REDAKTUAR] ndërsa i pandehuri [REDAKTUAR] i godet me grushta në trup të dëmtuarat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për çka të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] detyrohen të kërkojnë ndihmë në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj-Qendra Emergjente, lëndime këto të përshkruara në Ekspertizën mjeko-ligjore të datës 24.10.2017,-

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nëpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 188 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nëpar.1.1, 43 par.1 nëpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurit i :

GJYKON

1. [REDAKTUAR]

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 300 eurove (me shkronja:treqind euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i denuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj dënimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. [REDAKTUAR]

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 300 eurove (me shkronja:treqind euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i denuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj dënimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të dënimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me vendqëndrim në Ferizaj, Rruga, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] pa nr. , për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohen të pandehurit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor secili veq e veq të paguajnë shumën prej nga 40 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit që secili veq e veq të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.2135-7/17 i ka ngarkuar të pandehurit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dy nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 11.07.2018, mbajti shqyrtimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit, mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] (autorizimin gojarisht i akuzuari ia ka dhënë në séancë gjyqësore), ndërkaq Mbrojtësi i të dëmtuarës [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] nuk është paraqitur në shqyrtim gjyqësor edhe pse në Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të dt.04.06.2018 ka qenë i njoftuar, si dhe mungesën nuk e ka arsyetuar e as që ka kërkuar shtyerjen e shqyrtimit gjyqësor. Por, konform nenit 245 par.7 të KPPRK-së nuk kërkohet prezenca e dëshmitarëve.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit të dytë [REDAKTUAR] përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- Të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: Ekspertiza mjeko ligjore e dt.24.10.2017, si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu të akuzuarit janë udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar në fjalën e tyre në kuptim të mbrojtjes kanë deklaruar, pasi e kanë pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria janë penduar thellë për atë që e kanë kryer, por theksojnë se nuk kanë mundur ti kontrollojnë veprimet e veta në atë moment i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale, kërkon falje për këtë veprime me të dëmtuarit janë pajtuar, i pandehuri i parë është i martuar baba i 4 fëmijëve të cilët varen prej punës së tij, kurse i pandehuri i dytë është i pa martuar dhe i kanë propozuar gjykates që me rastin e matjes së dënimit si rrethana letësuese ti ketë theksësimet e sipër theksësuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figuren e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se të pandehurit kanë pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të kenë qenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, kanë kërkuar falje për veprimet e ndërmmarrura, i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale, duke qenë e bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke iu caktuar dënim më të butë dhe atë secilit veq e veq dënim me gjobë në lartësi prej nga 300 eurove.

Nëse i denuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj dënimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të dënimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPRK-së [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor secili veq e veq të paguajnë shumën prej nga 40 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit që secili veq e veq të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, të dëmtuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me vendqëndrim në Ferizaj, Rruga, [REDAKTUAR] pa nr. për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohen në kontest civil.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr.2892/2017 të dt.11.07.2018

Zyrtarja ligjore,
Liridona Mehmeti

Gjyqtari,
Elmaz Zenuni



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.

Të dëmtuarit mund të ushtronjë ankesë vetëm sa i përket sanksionit penal.

Nga një Kopje e aktgjykimit u dërgohet të dëmtuarve/ [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me vendqëndrim në Ferizaj, Rruga, [REDAKTUAR] pa nr.